

&



Raport nga hulumtimi “VLERËSIMI I NIVELIT TË SHIKUESHMËRISË DHE PENETRIMIT TË MEDIAVE- SENSIBILIZIMI”

Periudha tetor-dhjetor, 2011



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDJE - INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

Financues i Projektit:
Komisioni i Pavarur për Media

Nr.Prokurimit: 319-11-024-221

Zbatues i Projektit
Konsorciumit



mpr|group

Prishtinë, 2011

Përmbajtja

Hyrje	4
Qëllimi i projektit.....	6
Popullsia dhe pasqyra aktuale e shërbimeve mediale audiovizuale (televizive) në Kosovë	7
Metodologjia e mbledhjes së të dhënave.....	9
Gjetjet e hulumtimit dhe analiza e tyre	12
Përfundim	19
Aneks I Pyetëtori	22
Aneks II Tabelat e përpunimit të dhënave.....	24

Hyrje

Komisioni i Pavarur për Media (KPM) është në fazën përfundimtare të finalizimit të strategjisë që përcakton mënyrën dhe kohën për ndërprerjen e transmetimit analog dhe kalimin në transmetim digjital.

Një ndër elementet me rëndësi për studim, që duhet konsideruar gjatë këtij procesi, është mbledhja e të dhënave lidhur me pranimin e sinjalit televiziv tek familjet kosovare (niveli i penetrit). Ky hulumtim është i pari i kësaj natyre që organizohet nga KPM, ndërsa të dhënat që dalin nga ky hulumtim kanë rëndësi të veçantë për organizim dhe planifikim gjatë realizimit të procesit të digjitalizimit, respektivisht në planifikimet për ndërprerjen e transmetimit analog duke kaluar në transmetim digjital.

Ky hulumtim është me rëndësi të veçantë për autoritetin rregullativ në këtë rast për faktin se, përmes të dhënave që dalin nga ky hulumtim, nxirret një pasqyrë e qartë rreth numrit sa më të përafërt të familjeve për mënyrat e pranimit të sinjalit televiziv dhe të kapaciteteve aktuale të popullatës kosovare për pranim të sinjalit analog dhe të atij digjital në të ardhmen. Këto të dhëna do të shërbejnë edhe për institucionet tjera të përfshira në këtë proces të rëndësisë së veçantë për shtetin, përmes të cilave mund të planifikohet edhe një skemë ekonomiko-shoqërore e cila do të ketë rëndësinë në përcaktimin e kriterëve për ndarjen e subvencioneve të mundshme, dedikuar mundësisë së pranimit të sinjalit digjital, për kategori të ndryshme të shoqërisë sonë.

Gjithashtu, të dhënat e këtij hulumtimi, të nxjerra përmes një pyetësori të dizajnuar, paraqesin edhe opinionin e publikut lidhur me:

1. vetitë e përgjithshme për të shikuar programe televizive;
2. identifikimin e preferencave programore të cilat ofrohen nga shërbimet mediale audiovizuale; si dhe
3. mënyrën e preferuar të burimeve të informimit.

Në këtë mënyrë, KPM do të posedojë informacionet themelore për të krijuar një pasqyrë të përgjithshme rreth kërkesave dhe nevojave të publikut kosovar rreth çështjeve programore në përgjithësi, të cilat në procesin e digjitalizimit mund të shërbejnë për të bërë ndryshimet e nevojshme pozitive në aspektin programor.

Pjesë përbërëse e këtij projekti është edhe kampanja informuese e publikut kosovar rreth procesit të digjitalizimit, ku përmes fletëpalosjeve të shpërndara në territorin e Kosovës, përfshirë të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë, janë prezantuar informacionet bazë në mënyrë shumë të thjeshtë, lehtë për t'u kuptuar nga secila grupmoshë, duke ofruar sqarime për përparësitë që ofron transmetimi televiziv digjital dhe teknologjia që është e nevojshme për familjet (pajisjet e duhura për pranimin e sinjalit televiziv digjital) në mënyrë që, prej tani publiku të jetë i parapërgatitur mirë me informacione që në momentin e ndërprerjes së transmetimit analog, ata të jenë të gatshëm dhe të informuar për pranimin e sinjalit televiziv digjital. Kjo për arsye që të mos krijohet vakum informativ gjatë ndërrimit të teknologjisë transmetuese.

Sidoqoftë, kampanja informuese që është realizuar me këtë projekt, mund të konsiderohet vetë si fillim për sensibilizim të opinionit publik, por edhe të institucioneve përgjegjëse të Republikës së Kosovës, përndryshe në vende të Bashkimit Evropian, kampanja të tilla realizohen për disa vite me radhë para përfundimit të procesit, ku përmes metodave të tilla sigurohet informimi i mjaftueshëm i publikut për t'u përgatitur për kalim në transmetimin digjital.

Shpërndarja e fletëpalosjeve është realizuar në tërë territorin e Kosovës, duke fokusuar në 7 qendrat kryesore të Kosovës: Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Ferizaj dhe Gjilan, duke përfshirë të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë. Shpërndarja është realizuar në tri forma: 1) Derë më derë; 2) Në sheshet kryesore të qyteteve dhe lokale të ndryshme; 3) Nëpër vetura.

Dizajnimi i pyetësorit

Konsorciumit “Viprint dhe MPR Group” ka dizajnuar pyetësorin për realizimin e këtij hulumtimi. Në bashkëpunim me KPM-në është definuar mirë me qëllim

që të mblidhen të dhënat themelore që ndërlidhen me natyrën e këtij hulumtimi. Gjithashtu, edhe teksti i fletëpalosjes për kampanjën informuese për transmetimin digjital është hartuar në pajtim me kërkesat e KPM-së.

Pas miratimit të pyetësorit dhe të fletëpalosjes për kampanjën informuese, kompania hulumtuese “MPR Group” ka filluar punën në terren dhe duke filluar nga 26 nëntor 2011 deri më 10 dhjetor 2011, ka arritur të intervistojë gjithsej 3441 respondent dhe të shpërndajë rreth 230000 fletëpalosje për kampanjën informuese në territorin e Kosovës. Puna e përgjithshme në terren është bërë në mënyrë proporcionale në të gjitha komunat kryesore të Kosovës, përfshirë edhe pjesët rurale rreth atyre komunave.

Qëllimi i projektit

Ky hulumtim është i realizuar nga Kompania e specializuar për hulumtime të opinionit publik “MPR Group” në kuadër të konsorciumit “Viprint & MPR Group” e cila është kontraktuar nga Komisioni i Pavarur për Media.

Qëllimi i këtij hulumtimi është që të nxirren të dhënat themelore rreth:

1. Nivelit të penetrimit të mediave;
2. Vetive të shikueshmërisë së televizionit si dhe
3. Të realizohet nisma e një kampanje informuese për qytetarët e Kosovës, përmes së cilës ofrohen informacione dhe sqarime rreth përparësive që sjell procesi i digjitalizimit televiziv, përfshirë informacione rreth pajisjeve të nevojshme për pranim të sinjalit televiziv tokësor digjital.

Rezultatet e këtij projekti do të shërbejnë për Komisionin e Pavarur për Media gjatë fazës së hartimit dhe finalizimit të strategjisë për kalimin në transmetim digjital, në Republikën e Kosovës.

Popullsia dhe pasqyra aktuale e shërbimeve mediale audiovizuale (televizive) në Kosovë

Në bazë rezultateve preliminare të regjistrimit të fundit të Popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë, del se janë regjistruar gjithsej 1,733,872 rezidentë, ndërsa përfundimi i procesit të regjistrimit civil në tërësi planifikohet të realizohet deri në fund të vitit 2012. Në bazë të të dhënave të marra nga Ministria e Financave, mesatarja e numrit të anëtarëve për një familje është 6 anëtarë. Këto konsiderohet shifra të përafërta prandaj mund të shërbejnë në mënyrë të përafëruar për t'u bazuar për çdo planifikim.

Aktualisht në Republikën e Kosovës janë të licencuara 21 televizione të cilat 3 prej tyre transmetojnë në nivel nacional, 13 i takojnë shumicës shqiptare dhe 5 televizione i takojnë kategorisë regjionale/lokale në shërbim të komuniteteve joshumicë.

Transmetuesit që i përkasin kategorisë me mbulim nacional janë: RTK (transmetuesi publik), KTV dhe TV 21; ndërsa 18 transmetuesit që i përkasin kategorisë me mbulim regjional/lokal janë: TV Besa, TV Ballkan, TV Dukagjini, TV Festina, TV Herc, TV Iliria, TV Liria, TV Mir, TV Mitrovica, TV Men, TV Most, TV Opinion, TV Prizren, TV Puls, TV Syri Vision, TV Tema, TV Vali dhe TV Zoom¹.

Në Republikën e Kosovës janë të licencuara edhe 37 Ofrues të Shërbimeve Programore të cilat transmetojnë programin e tyre vetëm përmes rrjetit kabllor. Megjithatë, vetëm rreth 20 ofrues të shërbimeve programore, vërehen të jenë aktiv në rrjetët kabllore, të cilët transmetojnë përmbajtje programe. Ndërsa pjesa tjetër e të licencuarve nuk kanë arritur të fillojnë me shërbime programore, por që licencat e tyre janë akoma valide dhe ekziston potencial që edhe ata ofrues të shërbimeve programore të fillojnë të transmetojnë program.

¹ Informacione të marra nga faqja zyrtare e KPM-së <http://kpm-ks.org>

Në Republikën e Kosovës është i shpërndarë në masë të madhe edhe shërbimi i programeve përmes rrjetit kabllorë. Aktualisht, operator kabllor të licencuar dhe që janë aktiv me shërbimet e tyre në Kosovë operojnë 12 operator kabllor, ku 2 prej tyre (Ipko dhe Kujtesa) kanë shtrirje të rrjetit pothuajse në të gjitha komunat kryesore të Republikës së Kosovës (në nivel nacional), ndërsa pjesa tjetër e të licencuarve kanë shtrirje në nivel lokal (e kanë të shpërndarë rrjetin vetëm në një qytet), e ato janë: Dream (Dragash), Eagle (Prizren), Elektra (Hani i Elezit), TV Eho (Reçan), Eurina (Skenderaj), TV Net (Lubinje), Link Produkcija (Graçanicë), Kumanova (Therandë), DDO Progres (Shtërpce)².

Zhvillimi dhe implementimi i platformës IPTV (televizion përmes protokolit të internetit) është prezent dhe funksional në Republikën e Kosovës. Në bazë të të dhënave që janë ofruar nga zyrtarë përgjegjës të PTK-së, deri tani kjo kompani ka shpërndarë 3000 pranues (setup-box), ndërsa kërkesat e që kanë arritur deri tani në PTK për t'u kyçur në IPTV arrijnë deri në shifrën 7000. Sipas të njëjtëve zyrtarë, shpërndaja e këtyre pranuesve do të bëhet më së voni në muajin shkurt të vitit 2012. Mirëpo, çështje brengosëse mbetet moslicencimi i kësaj platforme e cila është pjesë e Postës dhe Telekomit të Kosovës – kompani publike³.

Në bazë të pasqyrës së licencimit të shërbimeve mediale audiovizuale, rrjeteve kabllore, ofruesve të shërbimeve programore, përfshirë edhe platformën IPTV, në Republikën e Kosovës ekziston një llojlojshmëri e kënaqshme e programeve dhe shërbimeve mediale audiovizuale në përgjithësi.

² Të dhënat nga adresari: <http://kpm-ks.org>

³ Të dhënat janë marrë gjatë intervistës me një zyrtar të PTK-së i cili dëshiron të mbetet anonim.

Metodologjia e mbledhjes së të dhënave

Për realizimin e këtij hulumtimi është përzgjedhur metodologjia kuantitative. Mënyra e mbledhjes së të dhënave është bërë përmes një pyetësi të dizajnuar me pyetje kryesisht të mbyllura, pyetje të cilat mbulojnë në tërësi çështjet e parapara për këtë hulumtim si: Kapacitetet teknike/teknologjike të familjeve (për penetrim të shërbimeve mediale audiovizuale) dhe vetitë e shikueshmërisë. Në përgjithësi, hulumtimi është realizuar në rajonet e paraqitura si më poshtë, përfshirë edhe zonat rurale të secilit rajon veç e veç. Sipas ndarjes së KPM-së, rajonet janë përcaktuar në këtë mënyrë:

1. Prishtina,
2. Mitrovica,
3. Peja,
4. Gjilani,
5. Prizreni,
6. Shtërpca dhe
7. Zubin Potoku/Zveçani/Leposaviqi;

Për këtë hulumtim është zgjedhur metoda e anketimit ballë-për-ballë. Është vendosur për të përdorur këtë metodë sepse ka disa përparësi në krahasim me teknika të tjera e në radhë të parë vije në shprehje vlerësimi i karakterit personal, mundësia e përsëritjes së pyetjes nëse nuk është kuptuar nga respondentit, koha relativisht e shkurtër, shkalla më e ultë e refuzimit të përgjigjeve, çmimi më i volitshëm, respondentët lejojnë kohë më të gjatë sidomos nëse anketimet kryhen nëpër shtëpi etj.

Seleksionimi i lagjeve dhe shtëpive është bërë në mënyrë të rastësishme (random), duke u dhënë paraprakisht hulumtuesve në teren udhëzime për numrin e shtëpive në mes të dy shtëpive të zgjedhura, anën e rrugës prej kah do të fillohet, numrin e kateve në mes të dy kateve të zgjedhura, apartamenteve, ku udhëzimet zakonisht dallojnë për zonat urbane dhe ato rurale, dendësia e banimit etj.

Po që se personi i zgjedhur nuk është në dispozicion, atëherë hulumtuesit i lejohen deri në 3 përpjekje (vizita e parë plus dy vizita tjera). Po që se edhe pas herës së tretë nuk ka sukses vizita, atëherë lejohet ndryshimi i respondentit në shtëpi tjetër, ndërsa shënohet si “anketimi nuk ishte i mundshëm” ose konsiderohet si refuzim.

Në fund, duke përsëritur dhe siguruar respondentin se përgjigjet e dhëna nuk do të zbulohen, anketuesit kanë kërkuar që të tregohet numri kontaktues i telefonit fiks apo mobil i cili do të përdoret nga financuesi i projektit për shkaqe të kontrollit.

Intervistat janë ndarë në mënyrë proporcionale për secilin rajon, ku afërsisht janë paraparë 500 respondent për një rajon.

Struktura e mostrës

Duke u përcaktuar në një mostër prej 3500 intervistash të realizuar në mënyrë proporcionale për secilin rajon dhe komunitet, është vlerësuar se një numër i tillë respondentësh është reprezentativ për tërë territorin dhe specifikat që ka popullsia e Kosovës duke përfshirë të gjitha variablat e ndryshme socio-demografike; duke përfaqësuar popullatën e Kosovës në të gjitha segmentet e saj, përfshirë të gjitha komunitetet që zyrtarisht jetojnë në Kosovë. Një mostër e tillë garanton rezultate të besueshme që mund të shfrytëzohen sa i përket shikueshmërisë dhe nivelit të penetrimit të shërbimeve mediale audiovizuale në Kosovë.

Sa i përket variablave socio-demografike, në këtë hulumtim janë marrë parasysht:

1. regjioni,
2. grup-mosha,
3. gjinia,
4. kualifikimet,

Ndërsa, sa i përket variablave mediale (shërbimeve mediale audiovizuale), në këtë hulumtim janë marrë parasysh:

1. mënyra e pranimit të sinjalit televiziv,
2. numri i aparateve televizive dhe lloji i tyre.
3. formati i programeve televizive – besueshmëria.


Gjetjet e hulumtimit dhe analiza e tyre

Përmes realizimit të intervistimit të gjithsej 3441 respondentëve, ku respektivisht janë intervistuar 2817 respondent të shumicës shqiptare, 451 të komunitetit serb, 98 të komunitetit turk, 35 të komunitetit boshnjak, 26 të komunitetit RAE dhe 14 të komuniteteve tjera, prej tyre 2303 janë meshkuj dhe 1138 janë femra, kompania ka arritur të sigurojë të dhënat lidhur me:

1. Numrin e aparateve televizive në një familje
2. Detajet dhe specifikat (llojin) e TV aparateve në familje
3. Llojin e pranimit të sinjalit televiziv (tokësor, kabllor, Satelit, IPTV);
4. Identifikimin e vetive të përgjithshme për të shikuar programe televizive;
5. Identifikimin e preferencave programore
6. Mënyrën e preferuar të burimeve të informimit.

Në zonën urbane janë realizuar 2526 intervistat, ndërsa në zonën rurale janë realizuar gjithsej 915 intervista. Shpërndarja e intervistimit të respondentëve nëpër rajone është realizuar sipas tabelës si në vijim:


Rajoni		
	Në numra	%
Prishtina	789	22.9%
Mitrovica	650	18.9%
Peja	537	15.6%
Prizreni	476	13.8%
Ferizaj	488	14.2%
Gjilani	501	14.6%
Total	3,441	100.0%



Detajet rreth gjetjeve të hulumtimit janë të paraqitura përmes grafikoneve të cilat përmbajnë numrat dhe përqindjet për secilën pyetje:


Numri i aparateve televizive në një familje

Marrë në përgjithësi nga të gjithë të anketuarit janë përgjigjur që mbi 70% posedojnë vetëm nga një aparat televiziv. Ndërsa, rreth 25% janë deklaruar që posedojnë më tepër se 2 televizione për shtëpi.



Lloji i aparatit televiziv


Sa i përket llojeve të aparateve televizive që i posedojnë të anketuarit rreth 60% janë deklaruar se posedojnë aparate televizive digjitale.



Pranimi i sinjalit televiziv


	Specifikoni pranimi i sinjalit televiziv?
1. Tokësor	22.7%
2. Kabllorik	49.2%
3. IPTV	1.6%
4. Satelitor	8.2%
5. Internet	17.9%
6. Nuk ka fare TV	0.5%
Totali	100.0%

Një prej pyetjeve ka qenë specifikimi i pranimit të sinjalit televiziv, ku gati gjysma e të anketuarve janë deklaruar se pranimin e sinjalit televiziv e marrin nga kabllorët.



Shikueshmëria e televizioneve gjatë 24 orëve

Nëse e marrim një mesatare gjatë 24 orëve, më së shumti shikohet nga 3 orë në ditë televizioni, pasi që 28.6% janë përgjigjur që e shikojnë televizionin nga 3 orë në ditë, nga 4 orë e shikojnë rreth 22% e kështu me radhë.



Respondentët e anketuar më së shumti e shohin televizionin gjatë mbrëmjes, ku janë deklaruar rreth 80%. Gjithashtu, një numër më i vogël janë deklaruar që e përcjellin gjatë mesditës dhe në mëngjes, 13.6% respektivisht 5.1%.




Preferenca e stacioneve televizive


Më tepër se gjysma e respondentëve janë deklaruar që i preferojnë 3 televizionet me mbulim nacional (RTK, KTV dhe TV 21), ndërsa 33.5% e respondentëve preferojnë TV stacionet tjera, duke përfshirë këtu edhe përgjigjet e komuniteteve të tjera që janë deklaruar se preferojnë televizionet në gjuhën e tyre përkatëse.



Gjithashtu të anketuarit janë deklaruar për preferencat e tyre programore, ku dominon preferenca për programet argëtuese, pasi që janë deklaruar shumica e respondentëve apo 25.4%. Pastaj, rreth 23.3% janë deklaruar për lajmet, e më pas vjen sporti me 17.4%.



Preferencat televizive fokusohen kryesisht në kategoritë “cilësia më e mirë “ 41.1 % e respondentëve; “emisionet argëtuese” 13.5 % e respondentëve dhe “sporti 12.8%;



Qytetarët janë të kënaqur me formatin e programit televiziv ku shumica apo rreth 78% janë deklaruar se skema programore e ofruesve të shërbimeve vizuale është e mirë. Dhe vetëm 5.5% mendojnë se formati i programit televiziv është i dobët.



Përfundim

Realizimi i hulumtimit lidhur me “Vlerësimin e nivelit të shikueshmërisë dhe penetrimit të mediave-sensibilizimi” është kryer në përgjithësi me sukses. Si pjesë e vështirësive të realizimit të projektit mund të konsiderohet intervistimi me respondentët e komunitetit serb, ndërsa kompania nuk ka arritur të realizojë vetëm 59 intervista. Margjina e gabimeve në këtë projekt është +/- 3 %

Niveli i penetrimit:

Në bazë të rezultateve të nxjerra nga përpunimi i të dhënave që janë mbledhur në terren, mund të konstatohet se në Republikën e Kosovës sinjali televiziv pranohet në platforma të ndryshme, ku dominimin më të lartë e mbanë platforma kabllore me një përqindje prej 49.2%, për dallim nga transmetimi tokësor që në bazë të këtij hulumtimi del se 22.7 % e të intervistuarve janë deklaruar për pranim të sinjalit televiziv. Pjesa tjetër e të intervistuarve pranojnë sinjalin televiziv përmes platformave tjera si satelit, IPTV dhe internet, ndërsa janë deklaruar që nuk kanë fare aparat televiziv vetëm 0.5 % e të intervistuarve. Në bazë të këtyre rezultateve, mund të konkludohet se një pjesë e konsiderueshme e popullatës pranon sinjalin televiziv përmes platformës kabllore, dhe kjo mund të konsiderohet një përparësi me rëndësi të lartë për Kosovës, sa i përket procesit të digjitalizimit në përgjithësi.

Në bazë të të dhënave të dala nga respondentët e këtij hulumtimi del se 2083 të intervistuar posedojnë televizion LCD digjital, për dallim që 1335 të intervistuar janë deklaruar se posedojnë aparat televiziv analog. Nga të gjithë të intervistuarit, 71.5% posedojnë vetëm një aparat televiziv ndërsa, pjesa tjetër kanë dy e më shumë aparate televizive. Megjithatë, edhe kjo e dhënë konsiderohet si një përparësi tjetër për procesin e digjitalizimit në Kosovë.

Këto rezultate do të shërbejnë për definimin e udhërrëfyesit (roadmap) për strategjinë e ndërprerjes së transmetimit analog në Republikën e Kosovës. Të sigurojnë burime të mjaftueshme financiare për realizimin e strategjisë për digjitalizim, që ajo të jetë e implementueshme për tërë popullatën e Kosovës, në mënyrë jo-diskriminuese duke siguruar gjithashtu edhe pranues adekuat të sinjalit digjital, me një çmim të arsyeshëm dhe të pranueshëm për standardin ekonomiko-shoqëror kosovar, duke marrë parasysh se vetëm 38.8 % nuk posedojnë televizion digjital (HD ready), ndërsa pjesa tjetër sipas këtij hulumtimi nuk kanë nevojë për pajisje shtesë.

Vlerësimi i shikueshmërisë – vetitë:

Sa i përket shikueshmërisë dhe vetive të të shikuarit televizion, në bazë të rezultateve të hulumtimit 50.5% e të intervistuarve shikojnë televizion 3-4 orë në ditë, ndërsa koha më e madhe e shikueshmërisë është koha e mbrëmjes ku 79.2 % e respondentëve janë deklaruar për këtë periudhë kohore. Sa i përket preferencave televizive, 66.5 % e respondentëve preferojnë të shohin televizionet me mbulim nacional (RTK, KTV dhe TV 21), ndërsa 33.5% e respondentëve preferojnë TV stacionet tjera.

Preferencat televizive fokusohen kryesisht në kategoritë “cilësia më e mirë “ 41.1 % e respondentëve; “emisionet argëtuese” 13.5 % e respondentëve dhe “sporti 12.8%; ndërsa kategoritë programore si filmat dhe serialet janë arsye të mbesin në pjesën tjetër të përqindjes së respondentëve dhe janë më pak të preferuara.

Kampanja informuese:

Në bazë të të dhënave të dala nga pyetësi, nga të gjitha intervistat e realizuar vetëm 7.9 % e tyre janë në dijeni të plotë rreth transmetimit televiziv digjital; 34.8% janë të informuar mjaftueshëm; 38.8 % kanë pak informacione ndërsa 15.5 % nuk kanë asnjë informacion rreth transmetimit televiziv digjital.

Duke marrë parasysh se qytetarët (shikuesit) duhet të dinë dhe të kuptojnë se çka do të ndodhë gjatë procesit të digjitalizimit por edhe pas përfundimit të tij,

konsiderojmë se kampanja informuese, për këtë proces dhe në këtë fazë të cilën është Kosova, ka arritur efekt të kënaqshëm pasi që mbi 230000 fletëpalosje janë shpërndarë në tërë territorin e Kosovës, përfshirë edhe komunitetet tjera joshqiptare. Një pjesë e konsiderueshme e qytetarëve e kanë komentuar në mënyrë pozitive kampanjën informuese për procesin e digjitalizimit, duke e mirëpritur atë si shumë të nevojshme në këtë fazë. Ka pasur edhe prej atyre që nuk kanë pas fare informacione se çka në fakt është transmetimi digjital.

Aneks I Pyetëtori

DATA E INTERVISTËS

KODI I INTERVISTËS

KODI I KOORDINUESIT

KODI I RAJONIT

LLOJI I VENDBANIMIT (1-URBAN; 2-RURAL/FSHAT)

GJINIA E TË ANKETUARIT (1-MASHKULL; 2-FEMËR)

KODI I PIKËS MOSTRUESE

KODI I LISTËS SË KONTAKTIT

KODI I LISTËS KONTROLLUESE

KOMUNA	
RRUGA	
NUMRI	
KATI	
EMRI I APARTAMENTIT	
PËRSHKRIMI I ADRESËS	

Unë, koordinuesi për këtë projekt e vërtetoj se ky pyetësor është shikuar dhe kontrolluar në përputhshmëri me të gjitha instruksionet!

Data dhe nënshkrimi: _____

A është kontrolluar ky qq në terren dhe kush e kontrolloi?	
A është shikuar ky qq për kontroll logjik dhe kush e shikoi?	
Kush i kodoi përgjigjet nëse ka patur ndonjë kodim?	
Kush i bëri hyrjet e të dhënave të këtij pyetëtori?	
Kodi i pyetësit në sistemin e hyrjes së të dhënave	
A është kontrolluar ky qq për hyrje të të dhënave dhe kush e kontrolloi?	

Lloji i gabimit	Kontrolli logjik	Hyrja e të dhënave
I – numri i pyetjeve pa përgjigje të shkruara aty ku duhet të shkruheshin		
II – numri i pyetjeve gabimisht të kapërcyera apo të shtruar (aty ku janë shtruar, por është dashur të kapërcehen)		
III – numri i pyetjeve ku përgjigjet nuk janë shkruar në mënyrë të drejtë		
IV – numri i pyetjeve ku nën “Diçka tjetër” nuk është shkruar agjë por pyetja është shënuar si e përgjigjur		

KOHA E FILLIMIT TË INTERVISTËS:		
	ORA	MIN

Q1. Përkatësia etnike!

- | | |
|-------------|---|
| 1. Shqiptar | 1 |
| 2. Serb | 2 |
| 3. Turk | 3 |
| 4. RAE | 4 |
| 5. Tjetër | |

Q2. Në cilën datë, muaj dhe vit keni lindur? (Shënoni datën ashtu si e thotë i anketuari!)

D	D	M	M	V	V	V	V
---	---	---	---	---	---	---	---

Q3. Sa vjet i mbushët në ditëlindjen e fundit? (Shënoni numrin!)

Shënoni numrin e vjetëve!

Q4. Cili është niveli më i lartë i shkollimit që keni përfunduar? (Rrëthoni vetëm një përgjigje!)

- | | |
|----------------------------------|---|
| 1. Fillor | 1 |
| 2. I mesëm | 2 |
| 3. Universitet | 3 |
| Mos lexoni! | |
| 9. Nuk di / Nuk do të përgjigjet | 9 |

Seksioni 1:

Tani i kam disa pyetje lidhur me temën të cilën ju shpjegova më lartë.

Q5. Specifikoni pranimi i sinjalit televiziv? (edhe nëse keni më shumë se një lloj të pranimit të sinjalit?)

- | | |
|----------------------------|---|
| 1. Tokësor | 1 |
| 2. Kabllorik | 2 |
| 3. IPTV | 3 |
| 4. Satelitor | 4 |
| 5. Internet | 5 |
| 6. Nuk ka fare TV | 6 |
| 7. Specifiko nëse të tjera | |

Mos lexoni!

- | | |
|----------------------------------|---|
| 9. Nuk di / Nuk do të përgjigjet | 9 |
|----------------------------------|---|

Q6. Çfarë lloji të aparatit televiziv keni? (Ju lutem specifikoni në detaje!)

- | | |
|----------------------------------|---|
| 1. Analog | 1 |
| 2. Digjital | 2 |
| Mos lexoni! | |
| 9. Nuk di / Nuk do të përgjigjet | 9 |

Q7. A keni më shumë se një aparat televiziv? (Nëse përgjigja është Po, pvetni: cekni sa dhe paraqitni llojin e tyre)

- | | | |
|----------------------------------|------|---|
| 1. Po | ►Q8. | 1 |
| 2. Jo | ►Q9. | 2 |
| Mos lexoni! | | |
| 9. Nuk di / Nuk do të përgjigjet | | 9 |

Q8. Sa TV i keni dhe çfar lloji?

- 1. 1 TV _____ 1
- 2. 2 TV _____ 2
- 3. 3 TV _____ 3
- 4. 4 TV _____ 4
- 5. 5 TV _____ 5

Q9. Bazuar në orë apo minuta, sa shikoni televizion çdo ditë?

Shënoni numrin e orëve ose minutave!

Q10. Kur shikoni televizion më së shumti?

- 1. Në mëngjes _____ 1
- 2. Në mesditë _____ 2
- 3. Në mbrëmje _____ 3

Q11. Cilin stacion televiziv e preferoni? (specifikoni edhe nëse ka më shumë se një)

Shënoni emrat e TV stacioneve!

Q12. Jepni arsyet pse e preferoni këtë stacion televiziv:

Q13. Çfarë lloje të programeve shikoni më së shumti?

- 1. Lajme _____ 1
- 2. Programe argëtuese _____ 2
- 3. Dokumentar _____ 3
- 4. Debate _____ 4
- 5. Sport _____ 5
- 6. Specifiko nëse ka të tjera _____

Q14. Cili është mendimi juaj për formatin e programit në përgjithësi të stacioneve televizive?

- 1. Shkëlqyeshëm _____ 1
- 2. Mirë _____ 2
- 3. Dobët _____ 3
- 4. Specifiko nëse ka mendim tjetër _____

Mos lexoni!

- 9. Nuk di / Nuk do të përgjigjet _____ 9

Q15. Sa shpesh i shikoni edicionet e lajmeve qendrore?

- 1. Çdo herë _____ 1
- 2. Herë pas here _____ 2
- 3. Asnjëherë _____ 3

Q17. Cili/cilat është/janë televizioni/et në të cilin/at i përcillni edicionet e lajmeve?

Q16. Sa janë relevante informatat që iu ofrohen nga stacioni televiziv të cilin e ndiqni (lokal apo nacional)?

- 1. Shumë _____ 1
- 2. Kënaqshëm _____ 2
- 3. Mjaftueshëm _____ 3
- 4. Dobët _____ 4

Mos lexoni!

- 9. Nuk di / Nuk do të përgjigjet _____ 9

Q17. Sa janë të sakta informatat që iu ofrohen nga TV stacioni i juaj i preferuar?

- 1. 100% _____ 1
- 2. 50% _____ 2
- 3. 0% _____ 3

Q18. A mendoni se qytetarët janë të informuar me kohë prej TV stacioneve lidhur me ngjarjet kryesore që ndodhin në komunën tuaj?

- 1. Po _____ 1
- 2. Nganjëherë _____ 2
- 3. Jo _____ 3

Mos lexoni!

- 9. Nuk di / Nuk do të përgjigjet _____ 9

Q20. Çfarë do të ndryshonit në programin e TV lokale? (specifikoni)

Q21. Çfarë mendoni se është performanca e TV stacioneve me mbulim mbar-Kosovar në kuptim të informatës dhe kualitetit të programit, përfshirë edhe sinjalin? A i plotësojnë nevojat tuaja si audiencë? (Ju lutem jepni komentet tuaja)

Q22. Sa keni informacione për tranmsetimin digjital në Republikën e Kosovës?

- 1. Shumë _____ 1
- 2. Mjaftueshëm _____ 2
- 3. Pak _____ 3
- 4. Fare _____ 4

Mos lexoni!

- 9. Nuk di / Nuk do të përgjigjet _____ 9

KJO ISHTE E TËRA. JU FALMNDERIT PËR KOHEN DHE KOOPERIMIN TUAJ.

KOHA E KOMPLETIMIT	ORE	MINUTA

Aneks II Tabelat e përpunimit të dhënave

Tabela 1.

Kodi i rajonit	
Prishtina	22.9%
Mitrovica	18.9%
Peja	15.6%
Prizreni	13.8%
Ferizaj	14.2%
Gjilani	14.6%
Total	100.0%

Tabela 2.

Lloji i vendbanimit	
Qytet	73.4%
Fshat	26.6%
Total	100.0%

Tabela 3.

Gjinia e të anketuarit	
Mashkull	66.9%
Femër	33.1%
Total	100.0%

Tabela 4.

Përkatësia etnike	
Shqiptarë	81.9%
Serb	13.1%
Turk	2.8%
RAE	0.8%
Boshnjak	1.0%
Tjerë	0.4%
Total	100.0%

Tabela 5.

Kategoria e moshës	
18-24	35.7%
25-34	29.0%
35-49	21.4%
50-64	12.1%
64+	1.8%
Total	100.0%

Tabela 6.

Niveli më i lartë i shkollimit	
Shkolla fillore	10.7%
Shkollë e mesme	64.7%
Universitet	24.1%
Nuk janë deklaruar	0.5%
Total	100.0%

Tabela 7.

Specifikoni pranimi i sinjalit televiziv?	
1. Tokësor	22.7%
2. Kabllorik	49.2%
3. IPTV	1.6%
4. Satelitor	8.2%
5. Internet	17.9%
6. Nuk ka fare TV	0.5%
Totali	100.0%

Tabela 8.

Çfarë lloji të aparatit televiziv keni?	
Analog	38.8%
Digjital	60.5%
Nuk ka përgjigje	0.7%
Total	100.0%

Tabela 9.

Q7. A keni më shumë se një aparat televiziv?	
Po	28.2%
Jo	70.8%
Nuk ka përgjigje	1.0%
Total	100.0%

Tabela 10.

Numri i TV për familje	
1 TV	71.5%
2 TV	24.5%
3 TV	1.2%
4 TV	0.5%
5 TV	0.1%
Nuk ka përgjigje	2.2%
Total	100.0%

Tabela 11.

Shikueshmëria e televizioneve gjatë 24 orëve	
1 orë	8.2%
2 orë	17.3%
3 orë	28.6%
4 orë	21.9%
5 orë	14.1%
6 orë	5.5%
7 orë e më tepër	4.4%
Total	100.0%

Tabela 12.

Kur shikoni televizion më së shumti?	
Në mëngjes	5.1%
Në mesditë	13.6%
Në mbrëmje	79.2%
Nuk ka përgjigje	2.1%
Total	100.0%

Tabela 13.

Cilat stacione televizive i preferoni?	
Televizionet nacionale	66.5%
Televizionet tjera	33.5%
Totali	100.0%

Tabela 14.

Arsyet pse i preferojnë këto stacione televizive	
Për shkak të sportit	12.8%
Për shkak të filma	6.4%
Për shkak të lajmeve	8.3%
Për shkak të serialeve	4.9%
Për shkak të emisioneve argëtuese	13.5%
Për shkak të cilësisë më të mirë	41.1%
Nuk ka përgjigje	13.2%
Total	100.0%

Tabela 15.

	Çfarë lloje të programeve shikoni më së shumti?
Lajme	23.3%
Programe argëtuese	25.4%
Dokumentar	14.6%
Debate	15.2%
Sport	17.4%
Të tjera	4.2%
Total	100.0%

Tabela 16.

Q14. Cili është mendimi juaj për formatin e programit në përgjithësi të stacioneve televizive?	
Shkëlqyeshëm	14.5%
Mirë	78.9%
Dobët	5.5%
Specifiko nëse ka mendim tjetër	0.2%
Nuk ka përgjigje	0.8%
Total	100.0%

Tabela 17.

Q15. Sa shpesh i shikoni edicionet e lajmeve qendrore?	
Çdo herë	29.9%
Herë pas here	59.7%
Asnjëherë	9.9%
Nuk ka përgjigje	0.5%
Total	100.0%

Tabela 18.

Q16. Cili/cilat është/janë televizioni/et në të cilin/at i përcillni edicionet e lajmeve?	
Televizionet nacionale	64.6%
Televizionet tjera	23.0%
Nuk i shikon lajmet	12.4%
Total	100.0%

Tabela 19.

Q17. Sa janë relevante informatat që iu ofrohen nga stacioni televiziv të cilin e ndiqni (lokal apo nacional)?	
Shumë	16.0%
Kënaqshëm	48.8%
Mjaftueshëm	31.9%
Dobët	2.2%
Nuk ka përgjigje	1.0%
Total	100.0%

Tabela 20.

Q18. Sa janë të sakta informatat që iu ofrohen nga TV stacioni i juaj i preferuar?	
100%	31.9%
50%	65.9%
0%	1.9%
Nuk ka përgjigje	0.4%
Total	100.0%

Tabela 21.

Q19. A mendoni se qytetarët janë të informuar me kohë prej TV stacioneve lidhur me ngjarjet kryesore që ndodhin në komunën tuaj?	
Po	34.4%
Nganjëherë	53.0%
Jo	11.8%
Nuk ka përgjigje	0.8%
Total	100.0%

Tabela 22.

Q20. Çfarë do të ndryshonit në programin e TV lokale?	
Të ketë programe argëtuese më tepër	4.3%
Të ketë filma më tepër	3.0%
Të ketë sport më tepër	5.3%
Të ketë seriale më tepër	0.6%
Të ketë programe edukative, arsimore-shkencore më tepër	15.6%
Të ketë kualitet më të mirë	17.7%
Nuk i shikoj fare TV lokale	14.9%
Nuk kish me ndryshu asgjë	21.0%
Nuk ka përgjigje	17.6%
Total	100.0%

Tabela 23.

Q21. Çfarë mendoni se është performanca e TV stacioneve me mbulim mbar-Kosovar në kuptim të informatës dhe kualitetit të programit, përfshirë edhe sinjalin? A i plotësojnë nevojat tuaja si audiencë?	
E mirë	35.2%
E kënaqshme	44.0%
Jo e mirë	8.7%
Nuk ka përgjigje	12.2%
Total	100.0%

Tabela 24.

Q22. Sa keni informacione për transmetimin digjital në Republikën e Kosovës?	
Shumë	7.9%
Mjaftueshëm	34.8%
Pak	38.8%
Fare	15.5%
Nuk ka përgjigje	3.0%
Total	100.0%

